REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01 -198075
Data/Datum/Date: 12 / 03 /2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -1-
PRISHTINË/A (2025)

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

---

Nr. 24 /2026
Datë: 12 .03 .2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019) dhe neni 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, duke u bazuar në nenin 371 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (Gazeta Zyrtare nr. 3/2013, 31.01.2013), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (Gazeta Zyrtare nr. 15/2017, 11.05.2017), si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa e av. Florim Vertopi, për përjashtim e z. Gjokë Radi anëtar ad-hoc i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat, i emëruar sipas vendimit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë nr. 15/2026 datë 30.01.2026, në shqyrtim dhe vendosje në rastin disiplinor: DPSDPLS.nr.19/2025, të iniciuar nga z. Mehdi Reshani, Kryetar i Odës së Përmbaruesve Privat ndaj Përmbaruesit Privat z. Isak Islami, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

3. Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Arsyetim

Av. Florim Vertopi, përfaqësues i autorizuar i përmbaruesit privat, Isak Islami, në seancën dëgjimore të datë 17.11.2025 ka kërkuar përjashtimin e anëtarit të Komisionit Driton Govori, me arsyetim se dispozita e nenit 371 e LPP-së përcakton përjashtimin, po ashtu edhe neni 5 i Udhëzimit Administrativ për procedura disiplinore 09/2014 që konkretisht që të dyja e potencojnë se në këtë rast vlejnë dispozitat e procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarit. Tutje, ai ka shtuar se nga këto baza përjashtimin e mbështesin edhe në nenin 67, pika a) dhe g), të LPK-së. Në fakt, Driton Govori në këtë rast është palë në procedurë dhe ka konflikt interesi që të jetë anëtar i këtij Komisioni Disiplinor. Driton Govori është nënkryetar i Odës së Përmbaruesve Privatë dhe po ashtu anëtar i bordit të Odës së Përmbaruesve Privatë.

Me datën 23.12.2025 me Vendimin nr. 437/2025 pranohet kërkesa e av. Florim Vertopi përfaqësues i autorizuar i përmbaruesit privat, Isak Islami, dhe autorizohet zëvendësanëtari i Komisionit Disiplinor ndaj përmbaruesit privat, Shermet Livoreka, i emëruar sipas vendimit të Ministres nr. 351/2025 të datës 01.08.2025 për vendosje në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025 të iniciuar nga z. Mehdi Reshani, kryetar i Odës së Përmbaruesve Privatë ndaj përmbaruesit privat z. Isak Islami, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat të mbajtur me datën 16.01.2026, që përbëhej nga Naim Meholli, kryesues, Ramush Bardiqi, anëtar, dhe Shermet Livoreka, zëvendësanëtar, në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025 ndaj përmbaruesit privat z. Isak Islami, përfaqësuesi i autorizuar i përmbaruesit privat, av. Florin Vertopi ka kërkuar përjashtimin e zëvendësanëtarit të Komisionit, Sheremet Livoreka, me arsyetimin se Sheremet Livoreka është anëtar i bordit të Odës së Përmbaruesve Privatë të Kosovës. Bordi është organ esencial dhe në rang më i fuqishëm pas Kuvendit të Odës së Përmbaruesve Privatë. Sheremet Livoreka është anëtar i Bordit dhe ai ka ndërmarrë veprime konkrete. Prandaj, kërkon nga Ministri i Drejtësisë që në bazë të nenit 67, pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe nenit 371 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit 5 UA -MD 09/2014, të marrë vendim dhe të pranojë në tërësi propozimin e tyre duke e përjashtuar nga vendosja në këtë komision disiplinor, sepse nga provat e paraqitura, pos që është vërtetuar se Sheremet Livoreka është palë në këtë procedurë, ai është edhe subjekt i drejtpërdrejtë i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. I autorizuari i përmbaruesit privat deklaron se pranimi i kërkesës së tyre për përjashtimin e zëvendësanëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Livoreka, do t'i kontribuonte gjykimit të paanshëm dhe të drejtë, si dhe do të ruante integritetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Me datën 30.01.2026 me Vendimin nr. 15/2026 pranohet kërkesa e av. Florim Vertopi përfaqësues i autorizuar i përmbaruesit privat, Isak Islami, dhe me këtë Vendim autorizohet përmbaruesi privat, Gjokë Radi, si anëtar ad-hoc i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat në shqyrtim dhe vendosje në rastin disiplinor DPSDPLS.nr.19/2025.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat të mbajtur me datën 11.02.2026, që përbëhej nga Naim Meholli, kryesues, Ramush Bardiqi, anëtar, dhe Gjokë Radi, anëtar ad-hoc në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025 ndaj përmbaruesit privat z. Isak Islami, përfaqësuesi i autorizuar i përmbaruesit privat, av.Florin Vertopi, ka kërkuar përjashtimin e anëtarit ad-hoc z.Gjokë Radi, me arsyetimin e mbështetur në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MD.nr. 09/2014, në nenin 370 dhe 371 të LPK-së, në nenin 67, pika a) dhe g), në nenin 3, 4, 6 dhe 8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Përfaqësuesi i autorizuar, av. Vertopi, arsyetimin për përjashtimin e anëtarit ad-hoc, Gjokë Radi, e mbështet në faktin se angazhimi i anëtarëve të Komisionit Disiplinor me mandat të shkurtër ndikon negativisht në pavarësinë dhe paanshmërinë e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, duke u nisur nga parimet themelore të OKB-së për pavarësinë e gjyqësorit, Konventën Evropiane për Lirinë dhe të Drejtat e Njeriut, Standardet nga Komisioni i Venecias dhe dispozitat kushtetuese të Republikës se Kosovës. Po ashtu, i autorizuari i përmbaruesit privat, av.Vertopi konteston edhe propozimin e dhënë nga kryetari i Odës së Përmbaruesve Privat për caktimin e anëtarit të këtij komisioni me arsyetimin se propozimi rrjedh vetëm nga kryetari dhe jo nga organet e Odës. Me këtë, sipas av.Vertopit, do të thotë se jo vetëm që është cenuar neni 370 i LPP-së, po është cenuar edhe neni 13, paragrafi 2 pika 2.3 e Statutit në fuqi të Odës.
I autorizuari i përmbaruesit privat kërkesën për përjashtim të anëtarit ad-hoc, z. Radi, e mbështet edhe në një rrethanë tjetër - një përshëndetje tepër miqësore në mes të propozuesit të procedurës disiplinore, z. Reshani me anëtarin ad-hoc të këtij Komisioni shtatë ditë pas mbajtjes së seancës dëgjimore, i cili ka qenë i dyshuar për shkelje të natyrës së caktuar dhe është përgjigjur para Komisionit Disiplinor me datë 16.01.2026, ndërsa sot po ai person është i ulur në anën e Komisionit Disiplinor për ta gjykuar një çështje.
Kjo rrethanë ka krijuar përshtypjen tek i autorizuari i përmbaruesit privat, av. Vertopi, se anëtari ad-hoc, z. Radi, dhe kryetari i Odës, z. Reshani - që njëherësh është edhe propozues i procedurës disiplinore ndaj autorizuesit - mund të kenë interesa të përbashkëta, prandaj nisur nga ajo që u tha më lart, i autorizuari av. Vertopi konsideron se nuk mund të ketë gjykim të drejtë nëse dyshohet me të drejtë në anëtarin e Komisionit Disiplinor, z. Gjokë Radi, dhe se emërimi i tij konsiderohet se është i kundërligjshëm.

Në këtë seancë dëgjimore, në deklarimin e tij, propozuesi i procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat, Isak Islami, njëherësh edhe kryetar i Odës së Përmbaruesve Privatë z. Reshani, kërkon që të refuzohet kërkesa e të autorizuarit të përmbaruesit privat, av. Vertopi, me arsyetimin se gjërat, në të cilat po thirret i autorizuari, nuk qëndrojnë konform nenit 370 (paragrafi 2), që thotë se anëtarët propozohen nga Oda e Përmbaruesve Privatë, ndërsa neni 399 (paragrafi 1) e specifikon se kryetari i Odës e përfaqëson Odën. Propozuesi i procedurës disiplinore në deklarimin e tij, po ashtu, e hedh poshtë si të pabazuar, të paqëndrueshëm dhe të ultë pretendimin për përshëndetje si më lart, pasi, siç u shpreh ai, "sa herë vijmë këtu, kushdo që të jetë nga kolegët, një përshëndetje të tillë e bëjmë me të, ku të njëjtën përshëndetje e kam bërë edhe herëve tjera, edhe sot, edhe me kolegun Isak Islami, ngase nuk mendoj që nuk më lejohet të përshëndetem me kolegë, pavarësisht pozicioneve procedurale".

Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë pasi shqyrtoi kërkesën, provat dhe procesverbalin, duke i analizuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se nuk ekziston asnjë nga shkaqet obligative për përjashtimin e anëtarit ad-hoc z. Radi, pretendimet e të autorizuarit janë ngritur për herë të tretë dhe ato tani nuk mbështeten në prova konkrete që do të krijonin dyshim objektiv mbi paanshmërinë e anëtarit ad-hoc z. Gjokë Radi, në shqyrtim dhe vendosje në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025 ndaj përmbaruesit privat z. Isak Islami.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Kryesuesit dhe Anëtarëve të Komisionit;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Përmbaruesit Privat dhe të autorizuarit të tij;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Odës së Përmbaruesve Privatë;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*